

**RAPORTI HIDROGJEOLOGJIK**

**OBJEKTI: "NDERTIMI I UJESJELLESAVE  
PER FSHATRAT FUSHEBARDHE DHE ZHULAT, GJIROKASTER"  
(FAZA PROJEKT-ZBATIM)**



INXHINIER PROJEKTUES	INVESTITOR	KLIENT
<p>Ing. Gjeolog Yzeir Miraka Nr.License: Gj.0244/2 (Pika 9e; Studime e projekte hidrogeologjike)</p> <p>Ing.Hidro Sahit Ngjeçi</p> <p>Ing.Hidro Fatjon Beqiraj</p>	<p>Ministria e Infrastruktures dhe Energjise</p>  <p>REPUBLIKA E SHQIPËRIE MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGIJE</p> 	 <p>"Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Gjirokastër" sh.a Administrator: Gentian Llogo</p>
<p><b>RAPORTI HIDROGJEOLOGJIK</b></p> 	<p>Miratuar</p> <p>Nr. fq/Formati</p> <p>28/A4</p> <p>/A3</p>	
<p>Fshati Fushebardhe &amp; Zhulat</p>		

**RAPORTI HIDROGJEOLGJIK**

**OBJEKTI: "NDERTIMI I UJESJELLESAVE**

**PER FSHATRAT FUSHEBARDHE DHE ZHULAT, GJIROKASTER"**

**PERMBAJTJA**

<b>1. HYRJE</b>	<b>3</b>
1.1. Gjeomorfologjia	3
1.2. NDERTIMI GJEOLGJIK I ZONES	4
1.3. Kushtet klimatike dhe hidrologjike	8
1.4. Pozicioni fiziko-gjeografik i objektit	9
1.5. Kushtet hidrologjike	9
1.6. Kushtet klimatike	10
<b>2. Shpërndarja brenda vjetore te reshjeve dhe te dhëna për prurjet ditore, mujore, shumëvjeçare.</b>	<b>15</b>
3.1. Prurja mesatare shumëvjeçare	15
3.2. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhës	16
3.3. Qëndrueshmëria e prurjeve ditore	17
Prurja maksimale	19
<b>3. Lagështia relative e ajrit.</b>	<b>21</b>
<b>4. Avullimi dhe evapotranspirimi.</b>	<b>21</b>
<b>VENDNDODHJA</b>	<b>22</b>
<b>KAPTAZHET</b>	<b>23</b>
<b>ANALIZAT KIMIKO-BAKTEROLOGJIKE TE UJIT TE BURIMEVE</b>	<b>28</b>

## 1. HYRJE

Ky relacion konsiston në nevojen qe ka Bashkia Gjirokaster dhe Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster sh.a. per ndertimin e ujesjellesave, perkatesisht kaptazheve, depove, tubacioneve te dergimit dhe rrjeteve te brendeshme per fshatrat Fushebardhe dhe Zhulat, ne qarkun e Gjirokastres.

### 1.1. Gjeomorfologjia

Nga ana e treguseve gjeomorfologjik ne vendin ku do te ndertohet ujesjellesi dallohet per vlera te medha dhe mesatare.

Nga ana morfogjenetike Reljevi i zones eshte mjaft i larmishem. Zhvillim te pjesshem ka sidomos relievi erozivo-denudues.

Fillimet e veta perroi i Zhulatit i ka ne afersi te fshatit Zhulat te rrethit te Gjirokaster.

Gjeresia e shtratit te lumit rralle e kalon 5m, dhe vende vende kanioni eshte i pakalueshem, mbasi jane formuar shkallezime dhe pragje te shumta.

Me tej lugina zgjerohet, dhe ne te djathte te saj dallohet niveli i pare dhe i dyte i taraces lumore qe shoqerohet nga nje kon i madh depozitimesh ne bashkim me lumin e Kardhiqit.

Ne ndodhjen e proceseve erozivo-denuduese ne lugines vend te rendesishem zene rreshqitjet e shumta dhe proceset e tjera te shpateve, te cilat per shkak te vlerave te larta te parametrave morfometrik te reljevit, perberjes litologjike dhe shkeputjeve te shumta tektonike, jane teper intensive .

Spektori i siperme i lugines dallohet per relief shume te crregullt per arsye te ndryshimeve litologjike, shkeputjeve tektonike dhe te erozionit.

Klima e lugines pasqyrohet me ndryshime te ndjeshme gjate shtrirjes se saj. Ne vecorite e klimes rol te madh luajne karakteri i perzgjatur i lugines, rrethimi nga vargje malore, rritja e lartesis se drejtim te pjeses se siperme, hapja e gjere ne drejtim te Vjoses.

Ne drejtim te rrjedhes se siperme klima behet me e ftohte.

Temperatura mesatare vjetore ndryshon nga sa qe ne lindje 13.4°C.

Sasia e rreshjeve ndryshon nga 1800-2000mm shih ne vit.

Burimet me te shumta takohen ne krahun e majte te lugines ne kontakt tektonik te qelqeroreve me fliшет. Midis tyre dallohen burimet e Zhulatit.

Nje pjese e mire e teritorit te vendit eshte e cveshur, por pjeserisht eshte e mbuluar nga dushqet dhe me pak nga shkurret mesdhetare si perralli, marja, mretja, shqopa etj.



## 1.2. NDERTIMI GJEOLGJIK I ZONES

- **Depozitimet Terigjene**

Keto depozitime perfaqesohen kryesisht nga depozitimet flishoidale te cilat shtrihen nga fshati Zhulat dhe deri ne luginen e Drinos .Ato perfaqesohen nga depozitime flishore te tipit te flishit te eger dhe nga depozitimit taracore te lumit te Kardhiqit.

Flishi paraqitet nga nderthurje alevrolitesh me ndershtresa ranori krysisht kuarcore te cimentuar me cimanta karbonatike dhe shume te rrudhosur.Keto depozitime jane te rrudhosura dhe he trajte pulle mbi gelqerore ne fshatin Zhulat. Persa i perket moshes gjeologjike keto depozitime i perkasin oligocenit te siperm. Trashesia e tyre shkon deri 150m.

- **Triasiku i siperm**

Depozitimet e ketij seksioni ne zonen Jonike perfaqesohen teresisht nga dolomite.

Ne pergjithesi dolomitet kane teksture masive dhe shtresezim te pa dallushem. Ne disa raste ne stomet dolomitike dallohen thierza dolomitesh copezore, madje dhe brekie dolomitike. Verehen edhe nderthurje dolomitesh te shtresezuar holle. Ne planet e mikroshtresezimite te ketyre te fundit paraqiten perqendrime bitumi. Ne kete rast dolomitet marrin pamjen e rreshpeve dolomitike bitumbartese. Nga pikpamja strukturale dolomitet jane kokerrvegjel gjer kokerrmesem. Kane ngjyre hiri-bezhe. Shpesh here verehen gjurmet e strukturave paresore. Kjo dukuri duket kur brenda dolomiteve verehet mbetje te gelqeroreve te pa dolomitizuar krejtesisht. Duke u bazuar ne keto vrojtime mendohet se prejardhja e ketyre dolomiteve eshte epigjenetike, nga zevendesimi i gelqeroreve me dolomit. Persa i perket trashesise se triasikut te siperm mendohet mbi 500m.

- **Depozitimet e Jurasikut te Poshtem (Liasi)**

Mbi depozitimet e triasikut te siperm ne menyre te perputhshme vendosen depozitimet e liasit. Depozitimet perfaqesohen nga dolomite ,gelqerore dolomitik dhe gelqerore ku ralle takohen dhe ndershtresa e konkrecione silicoresh. Mbi kete pako vendosen rreshpe argjilore, gelqerore argjilore, mergel, argjila dhe me ralle gelqerore copezore. Trashesia e liasit kane trashesine 300-400 m.

- **Depozitimet e Jurasikut te mesem (Dogeri)**

Depozitimet e dogerit ndahen ne disa pako:

Pakoja e poshteme perfaqesohet nga nderthurje rreshpesh argjiloro – gelqerore dhe opokash me ndershtresa te shumta strallore. Mbi te vendoset nje pako gelqeroresh shtresetrashme me nderthurje te rralla strallore. Pjesa e siperme e dogerit perfajqesohet nga gelqerore argjilore dhe epoka te nderthurur nga shkembinj silicore. Keta te fundit, ne disa vende kane perqendrim te madh sa qe mund te vecohet si pako radiolaritike. Trashesia luhetet nga 300m deri 800m.



- **Depozitimet e Jurasikut te siperm (malmi)**

Depozitimet e jurasikut te siperm vendosen ne menyre te perputhshme mbi ato te dogerit .Ne pikpamje litologjike depozitimet e malmit perfaqesohet nga nderthurje gelqeroresh mikrokokrrizore shtreseholle, zakonisht me ngjyre hiri te celur me thyerje si te farforit. Keto shtresa te holla gelqeroresh nderthurjen me shtreseza me nderfutje e konkrecione strallore. Ne depozitimet e Jurasikut te siperm takohen rralle here, kryesisht ne pjesen e poshteme te tyre edhe ndershtresa gelqeroresh copezore. Copezat e tyre perfaqesohen nga gelqerore dhe me rralle nga stralle. Ne pergjithsi coprizat jane te rumbullakuara dhe perhapen ne shkemb ne menyre te cregullt.

Trashesia e ketyre depozitimeve shkon deri 90m .

- **Kretaku i poshtem**

Depozitimet e kretakut te poshtem vendosen ne perputhje me ato te jurasikut te siperm. Nga ana litologjike depozitimet e kretakut te poshtem perfaqesohen nga nderthurje alternative gelqeroresh mikrokokrrizore me ngjyre te bardhe dhe thyerje porcelanoide, me gelqerore mergelore, gelqerore argjilore, me rralle me gelqerore kristallore dhe coprizore. Me keta shkembinj nderthuren dhe stralle.

Gelqeroret mikrokokrrizore, gelqeroret argjilore, dhe strallet ne pergjithsi jane shtrese holle me trashesi 2-3-5-10-cm. Shtresat e gelqeroreve brekcioze kane trashesi 0,6-3m. Coprat e shkembinjeve brekcioze jane gelqerore, ato jane qoshelie gjere ne gjysem te rumbullakuara dhe jane shperndare ne shkemb ne menyre te pa diferencuar. Masa cimentuese eshte karbonati i kalciumit me ngjyre hiri te hapur ne disa raste nuanca te kuqerremta. Trashesia e ketyre depozitimeve shkon 300-400m.

- **Kretaku i siperm**

Depozitimet e kretakut te siperm vendosen ne perputhje te plote stratigrafike mbi depozitimet e kretakut te poshtem. Ato perfaqesohen nga gelqerore mikrokokrrizore, me thyerje porcelanoide, gelqerore kristallore, gelqerore brekcioze dhe nderthurje strallore. Nga pershkrimi litologjik del se depozitimet e kretakut te siperm jane te ngjasheme me ato te kretakut te poshtem. I vetmi ndryshim, karakterit fushore eshte paksimi i silicoreve ne kretakun e siperm. Gelqeroret kristallore ne brendesi te tyre zakonisht kane shtresezim te valezuar.

Gelqeroret e brekcezuar perqendrohen ne pjesen e siperme te prerjes. Trashesia e shtresave brekcioze shkon 0,5-0,6-1m. Coprizat e ketyre shkembinjeve shperndahen duke u asortiruar vertikalisht duke dhene dukurine e "**graded bedding**". Masa cimentuese ne keta shkembinj eshte karbonati i kalciumit, qe ne disa raste, eshte i perzier me material argjilore ngjyre hiri e hapur. Nje karakteristik e gelqeroreve brekcioz eshte se jane shume kavernoze. Trashesia e ketyre depozitimeve shkon 200-300m.



• **Paleoceni i zones Jonike**

Depozitimet e paleogenit vendosen normalisht mbi depozitimet e kretakut te siperm. Nga pikepamja litologjike, perfaqesohet nga gelqerore organogjene copezore, gelqerore kristalore dhe gelqerore mikrokokrrizore. Gelqeroret coprizore mbizoterojne ne pjesen e poshteme te prerjes, jane pa shtresezim te qarte, vetem ne pjesen e sipërme verehet nje shtresezim I qarte, ku trashesia e shtresave arrin deri 0,8-1,2m. Ne sipërfaqe keta gelqerore jane kavernoze .

Gelqeroret kristalore jane te shtresezuar, me trashesi 20-40cm, e ndonjehere gjere 80cm. Shpesh kane teksture brezore madje dhe te valezuar.

Gelqeroret mikrokokrrizore jane ne pjesen e sipërme te prerjes dhe jane shtreseholle me trashesi 2-5-10 deri 20cm. Kane thyerje guackore me thyerje porcelanoide kane ngjyre hiri te bardhe deri ne ngjyre trandafili te celur. Ne ta verehen stiliolite te rralla. Strallet e pakta takohen ne trajte kokrecionesh dhe rralle ne shtreseza te holla. Zakonisht kane ngjyre hiri te mbyllur deri ne kafe. Trashesia e ketyre depozitimeve varjon nga 80 -110m.

• **Depozitimet e Eocenit**

Depozitimet e Eocenit do ti trajtojme sipas perberjes litologjike te tyre dhe ne vazhdimsi ne kolonen litologjike.

Depozitimet e eocenit fillojne me nje **pako karbonatike** e cila fillon me nje pako te gelqeroreve organogjeno-copezore, gelqerore mikrokokrrizore dhe gelqerore kristalore. Siper tyre vendosetvendosen nderthureje te gelqeroreve mikrokokrrizore me ato te organogjeno-copezore me nderthurje te rralla kokrecionesh deri ne thjerreza silicoresh. Mbi keta gelqerore vendoset **pakoja mergelore kalimtare** ku kalimi behet dora –dores, nga gelqeroret, ne gelqeroret pak te argjilizuar, me tej ne gelqerore pak te mergelizuar gjersa kalohet ne gelqerore fuqimisht te mergeluar dhe mergele. Ky ndryshim ndodh ne distance shume te vogel. Ne pergjithsi pakoja mergelore kalimtare perfaqeson nje trashesi te njetrajteshme, qe ne baze eshte kryesisht mergelore alevrolitore. Kurse me larte eshte kryesisht argjiloro-alevrolitoro-mergelore.

Ne baze te pakos mergelore kalimtare paraqiten disa ndershtresash gelqerorësh organogjene copezore.

Alevrolitet, argjilat mergelore dhe vete mergelet kane ngjyre hiri te celur me nuanca te kaltra ose jeshile. Por ka dhe raste ku mergelet kane ngjyre te murme gush-pellumbi.

Ne zonen jonike siper mergeleve vendoset **pakoja flishore**. Ne perberje te flishit marrin pjese tre komponente: ranore, alevrolite dhe argjilite. Te tre keta komponente nderthuren ne menyre karakteristike ritmike. Ne prerjet e ndryshme gjeologjike here mbizoteron nje komponent e here tjetri. Trashesia e ketyre depozitimeve shkon 800-1100m.



• **Depozitimet e oligocenit**

Depozitimet e oligocenit fillojne me nje pako krysisht ranore, jo shume te ngjeshur mbi te cilin vijojne depozitimet ritmike te flishit argjiloro ranorik. Me siper vazhdon dhe cfaqet nje horizont konglomeratesh. Me siper tyre ne prerje vendosen argjila alevritike e karbonatike, alevrolitesh dhe ranore me ndershtresa e stome ranoresh me trashaman qe here –here kalojne dhe ne konglomerate. Trashesia e ketyre depozitimeve shkon deri 900m

• **Depozitimet e miocenit**

Depozitimet e miocenit fillojne me nje pako argjilore me shtresezim te pa dallushem me ndertim ne trajte shukash dhe me ndashmeri levozhgore me karakter flishoidal. Mbi kete pako vendoset nje suite mergelore me ngjyre hiri te celur me nuanca kalteroshe e jeshile. Shume rralle ne kete suite takohen alevrolite dhe ranore, te cilet kembehen me tej me gelqerore organogjeno-copezore.

Pas miocenit zona jone u rrudhose dhe nuk ishte me ne regjimin detare. Trashesia e ketyre depozitimeve 250-200m

• **Depozitimet e kuaternarit**

Keto depozitime takohen ne te gjithë zonen tone dhe ato I ndajme nedepozitime te shtratit te sotem te lumit te cilat jane te shkrufta dhe depozitimet taracore lumore te cilat jane te cimentuara mire. Gjithashtu mbi flishin kemi dhe tokat e formuara nga alterimi, te cilat jane argjila te shkrufta. Trashesia e tyre luhetet nga disa cm deri 25-30m.

**KOLONA STRATIGRAFIKE E ZONES SE KARDHIQIT (ZONA JONIKE)**

Mosha	Trashesia	Litologjia	Pershkrimi I depozitimeve
Kuaternari (Q)	30-40 m		Argjila te shkrufta, konglomerate te pa cimentuar dhe te cimentuar dobet te perbere nga zaje te ndryshem.
Miocen	300 m		Argjila, argjila mergelore me ngjyre gri
Oligocen	90 m		Ranore, flish ranorik dhe konglomerate ne trajte gravelitesh.
Eocen	110 m		Ne pjesen e siperme nje pako flishore, pastaj me pakon mergelore dhe ne pjesen e poshteme me gelqerore organogjene e rralle kristalore .
Paleoceni	80 m		Gelqerore organogjeno copezore ,kristalore dhe mikrokokrrizore



Kretaku I siperm	300 m		Gelqeroer mikrokokrrizore me thyerje porcelanoide me pak silicore.
Kretaku I poshtem	400 m		Nderthurje gelqerore mikrokokrrizore ,mergelore, argjilore me pak straje.
Jurasiku I siperm	90 m		Gelqerore mikrokokrrizore me straje.
Jurasiku I mesem	80 m		Rreshpe argjiloro gelqeroreme shume straje
Jurasiku I poshtem	400m		Dolomite te nderthurur me gelqerore te dolomitizuar ,me rreshpe mergelore argjilore.
Triasiku I siperm	500 m		Dlomite me pamje sheqerore carjet e te cilave jane mbushur me bitum

### PROCESET GJEOLGJIKE

Proceset gjeologjike qe kane ndodhur jane:

- **Fenomeni i karstezimit**

Ky fenomen duket qarte ne gropezimin e reljevit karbonatik ne siperafe dhe forma ne trajte gropash te cilat jane mbushur me materjal terigje. Ne fushen karstike mungon levizja e ujrave .

- **Tektonika**

Ky fenomen eshte pak i zhvilluar ne grykat e ndryshme dhe ne daljen e ujrave qe shkarkojne nga shpellat karstike. Gjithashtu ne kete rajon eshte e zhvilluar disprishje tektonike regionale dhe lokale te cilat kalojne paralel dhe terthore strukturave duke nderlikuar shume morfologjine e relievit.

Per tu permendur jane thyerjet e tipit te larthedhjeve Borsh – Kardhiq, Tepelene – Delvine dhe thyrja Fterre – Smokthine.

Aktiviteti sizmik lidhet me aktivizimin e thyrjeve tektonike.

Rajoni I lugines se se Kardhiqit futet ne zonen me intesite 8 balle (klasifikimi me 12 balle sipas shkalles se Merkali), Trualli trajtohet si I kategorise se pare.

### 1.3. Kushtet klimatike dhe hidrologjike

Objekti i ketij studimi eshte te japë te dhënat e nevojshme meteorologjike dhe hidrologjike për hartimin projektit te ujesjellesave.

Ne pjesën e pare trajtohen te dhënat meteorologjike te ketij pellgu ujëmbledhës.



Ne pjesën e dyte trajtohen kushtet hidrologjike dhe llogaritjet hidrologjike për këtë lum.

#### 1.4. Pozicioni fiziko-gjeografik i objektit

Pellgu ujëmbledhës i lumit të Zhulatit sipas klasifikimit gjeografik të vendit të tij hyn në krahinën malore jugore (Malësia karstike e Kurveleshit), pjesa jugore e saj.

Nga veriu kufizohet me zonën malore të Golemit, mali i Thate 1567 m m.n.d deri në kuotën 1260 m m.n.d., nga lindja me malin e Pusit 1564m.n.d nga mali i Cekes 1521m.n.d. deri tek arat e Kaparelit 1428m.n.d., dhe në perëndim nga qafa e Buza Gomares-qafa Gjoshnikashi 1478m.n.d deri tek arat e Fonices.

Format sipërfaqësore me të mëdha janë fushat karstike si ajo e Golemit me sipërfaqe mbi 3 km<sup>2</sup> secila, kanë forme vezake dhe janë të mbyllura nga të gjitha anët.

Lugina e Kardhiqit ndërtohet nga formacione karbonike të pasura me fosfate, evaporite, flishe dhe në sektorë të kufizuar nga depozitime kuaternare, Midis formacioneve karbonike përhapjen me të madhe e kanë gelqeroret e Kretakut të cilët janë mjaft të karstezuar.

Pellgu ujëmbledhës i lumit të Kardhiqit dallohet për kontraste të theksuara të relievit, të cilat shtrihen nga rreth 500 m deri në mbi 1500 m, pra amplituda hipsometrike në të është e madhe.

Në këtë malësi ka përputhje të morfologjive me strukturën gjeologjike; mospërputhjet përbejnë raste të veçanta-Lugina e Zhulatit.

Fusha karstike e Golemit është e thate, ka vetëm dy burime të përkohshme që lidhen me horizontin fosfatik në të cilin është vendosur fshati me të njëjtin emër.

Lloji i tokave është kryesisht të kuqe dhe me bimësi tipike kserofile, janë të lidhura me karstin shumë të zhvilluar.

Megjithatë në luginën e Zhulatit takohen disa breza tokash që fillojnë nga të hirta kafe deri në ato livadhore malore.

Lugina e Zhulatit dallohet nga një morfologji e çrregullt me plot zgjerime litologjike të shtratit të lumit dhe degëve të tij.

#### 1.5. Kushtet hidrologjike

Lumi i Zhulatit është fillimi i lumit të Kardhiqit, dege kryesore e lumit Drinos.

Zanafilla e lumit të Zhulatit janë mali i Thate 1567 m.n.d dhe qafa e Buza Gomares 1365m.n.d.

Lugina e Kardhiqit vendoset midis Kurveleshit të sipërm dhe Malit të Gjere. Hapet vetëm në drejtim të lindjes të luginës së Drinosit, kurse nga anët e tjera rrethohet nga mallet.

Tipi i relievit eroziv denodues zë gjithashtu një pjesë të mirë të sipërfaqes. Përfaqësohet nga përroska të shumta erozive, përrenj që gjatë pjesës me të madhe të vitit janë pa rrjedhje, rrëzime e rrëshqitje.



Lugina e Kardhiqit karakterizohet nga reshje te mëdhaja vjetore mbi 2000 mm ne vit dhe reshje me te mëdhaja 24 orëshe në pjesën e sipërme të lumit, bien dhe sasi te mëdhaja reshje bore.

Pellgu ujëmbledhës i lumit te Kardhiqit ka një sipërfaqe ujëmbledhëse  $F=187 \text{ km}^2$ . Matjet e prurjes kane filluar qe nga viti 1947 në urën e Kardhiqit.

#### 1.6. Kushtet klimatike

Sipas klasifikimit klimatik te vendit tone zona qe po studiojmë hyn ne nënzonen klimatike mesdhetare malore jugore.

Ne pjesën perëndimore te kësaj zone malësia e Kurveleshit, pjesa e sipërme e lumit te Zhulatit (fillimi i lumit te Kardhiqit), vlerat e temperaturave mesatare shumëvjeçare lëvizin nga  $12^{\circ}\text{C}$  nga  $14^{\circ}\text{C}$ . Mesatarja e temperaturave te muajit janar, si muaji me i ftohte i vitit, varion nga  $1^{\circ}\text{C}$  deri ne  $2.5^{\circ}\text{C}$ . Minimumet absolute te temperaturës janë me pak te theksuara se zonat e tjera te marra ne studim, ne malësinë e Kurveleshit ato variojne nga  $-12^{\circ}\text{C}$  deri  $-15^{\circ}\text{C}$ .

Një analize e hollësishme e temperaturës se ajrit për lumin e Zhulatit tregohet ne tabelën Nr.1 dhe ilustrimi ne figurën bashkangjitur ku jepen temperaturat e ajrit dhe shpërndarja e saj gjate vitit.

Siç tregohet me poshtë shpërndarja e reshjeve gjate vitit ka formën e “U-se” qe është tipike e një regjimi mesdhetar te reshjeve. Sasia me e madhe gjate periudhës se ftohte te vitit dhe muajt me te laget janë nëntor-shkurt. Ne vendmatjen meteorologjike Nivice ne vitin 1969 kane rënë 3350 mm dhe në dhjetor te këtij viti kane rënë 1012 mm,

Ne vitin 1984 kane rënë 1390mm, ne Kuç 1963 kane rënë 3289mm dhe ne muajin shkurt te këtij viti kane rënë 762mm dhe viti me i thate është 1975 ku kane rënë ne Kuç 1450 mm.

Ne Kardhiq ne vitin 1963 kane rënë 3500 mm dhe ne muajin shkurt te këtij viti kane rënë 1244 mm. Duke pasur parasysh sasinë maksimale për 24 ore te reshjeve dhe intensitetin për intervale te ndryshme kohe, kjo zone karakterizohet nga një intensitet te madh te reshjeve (shiko tabelën dhe ilustrimin).

Tabela Nr.1. Temperatura e ajrit Vendmatja Nivice


Nr	Emërtimi	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Shuma vjetore
1	Temp.mes.vjet.	4,3	4,8	6,7	9,3	14,4	18,5	20,6	20,7	17,5	12,9	8,3	5,4	12,0
2	Temp.mes.max.	7,8	8,6	10,9	13,7	19,4	24,1	26,7	26,5	22,8	16,9	12,3	9,3	16,6



UJESJELLESAT FUSHEBARDHE & ZHULAT

3	Temp.mes.min.	0.7	1.1	2.5	4.9	9.3	12.9	14.7	14.9	12.2	8.6	4.4	1.5	7.3
4	Temp.max.abs.	17.8	19	23.2	24.7	31	33.5	36.6	35.2	34.6	28.7	22.7	17.3	36.6
5	Temp.min.abs.	-15.4	-11.7	-11	-1.8	0.7	4.2	7.6	8.3	2.2	-2.2	-6.1	-9.8	-15.4

Temperatura e ajrit Vendmatja Nivice



Temperatura e ajrit Vendmatja Kuç

Nr	Emërtimi	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Shuma vjetore
1	Temp.mes.vjet.	5.7	6.6	8.3	11.3	16	20.5	23	22.9	20	16	11	7.8	14.1
2	Temp.mes.max.	8.5	9.6	11.9	15.1	20.1	24.6	27.6	28.1	24	18.5	14	10.4	17.7
3	Temp.mes.min.	2.6	3.2	4.7	7.4	11.9	15.4	16.9	16.8	18.3	10.3	6.9	3.7	9.5
4	Temp.max.abs.	17.5	20.6	23.6	25.5	31.0	36.6	40.2	40.1	36.4	31	26.4	20.6	40.2
5	Temp.min.abs.	-12.6	-9.8	-6.1	-2.8	-0.4	7.1	10	10.2	5.2	1	-4.5	-7	-12.6

Temperatura e ajrit Vendmatja Kuc




Tabela Nr.2. Reshjet mujore dhe vjetore

Nr	Emërtimi	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Shuma vjetore
1	Nivic	337	299	232	272	119	54	38	42	115	227	391	406	2430
2	Kuç	363	302	214	156	108	43	30	42	119	225	389	393	2390
3	Kardhiq	374	320	200	145	85	41	21	34	104	234	388	401	2350
4	Ura e Leklit	273	262	177	122	85	40	32	36	77	180	331	331	1950

UJESJELLESAT FUSHEBARDHE & ZHULAT

Reshjet mujore dhe vjetore





Tabela Nr.3. Reshjet me te mëdhaja 24 orëshe

Nr	Emërtimi	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Me e larta
1	Nivic	185	150	190	116	173	60	57	65	175	186	263	196	263
2	Kuç	152	153	106	105	125	56	57	115	96	200	206	161	206
3	Kardhiq	186	273	136	120	77	47	24	64	124	194	279	225	279
4	Ura e Leklit	160	215	112	73	93	40	47	29	83	155	191	170	215

Reshjet me te medhaja 24 oreshe



Ne vendmatjen meteorologjike Kardhiq kane rene për 24 ore 279 mm, ne Nivicë 263 mm, Urën e Leklit 215 mm dhe Kuç 206 mm.

Stina e verës paraqitet me e thate, se ne te gjithë zonat e tjera klimatike te vendit, gjithashtu dhe numri i ditëve me reshje është me i vogël se ne zonat e tjera.

Pellgu i lumit te Kardhiqit preket shpesh dhe nga breshëri dhe ka numrin me te madh te ditëve me breshër ne te gjithë krahinën malore jugore.

Lartësia mesatare maksimale e bores arrin deri ne 40 cm ndërsa ne lartësitë e majave trashësia e bores dhe kohëzgjatja e saj është me e madhe. Klima e kësaj zone dallohet nga zonat përreth sepse ndikon fuqishëm lartësia e madhe mbi nivelin e detit. Ka dimra te ftohte dhe shume te laget dhe vere te thate e ne përgjithësi te freskët.

2. Shpërndarja brenda vjetore te reshjeve dhe te dhëna për prurjet ditore, mujore, shumëvjeçare.

Studimi i rrjedhjes ujore të lumit Kardhiq bazohet në të dhënat hidrologjike të vendmatjes se Palokastrës në lumin Kardhiq. Te dhënat mbi rrjedhën ne këtë vendmatje disponohen për vitet 1978-1992, te cilat jane marre nga Buletinet Hidrologjike te botuara nga Instituti Hidrometereologjik.

Hidrologjia e Lumit te Kardhiqit shtjellohet sipas këtyre kapitujve:

- Prurja mesatare shumëvjeçare
- Prurja mesatare shumëvjeçare me siguri te ndryshme.
- Shpërndarja brendavjetore e rrjedhës.
- Qendrueshmerija e rrjedhës ditore.
- Prurja maksimale.

### 3.1. Prurja mesatare shumëvjeçare


Prurja mesatare shumëvjeçare e përcaktuar nga seria e vrojtimeve te periudhës 1978-1992 rezulton të jetë  $7.06 \text{ m}^3/\text{s}$ .

Kjo seri vrojtimi është relativisht e shkurtër dhe ka shume te ngjare qe mesatarja e përcaktuar sipas saje te mos përfaqësoje madhësinë e vërtete, kjo periudhe mund te bjere ne vite te thate ose ne vite te laget. Për këtë arsye është tentuar të zgjatet kjo seri. Si analog për zgjatjen nga lumenjtë fqinje u zgjodh lumi Drinos ne Urën e Leklit me periudhe vrojtimi 1948-1990. Ekuacioni i lidhjes është:

$$Y = 0.1773 * X^{1.0879} \text{ dhe } R = 0.93$$



Korrelacioni i prurjeve vjetore



Shikojmë që merret një lidhje mjaft e mire. Me këtë ekuacion është zgjatuar seria e vërtetimeve në Kardhiq duke sjelle atë në periudhën 1948-1992. Në bazë të kësaj serie u përcaktua prurja mesatare shumëvjeçare për serinë e zgjatuar 1948-1992 e cila rezultoi 9.01 m<sup>3</sup>/s.

Një analizë e ngjashme është bërë dhe duke lidhur Shushicën në Kuç me Kardhiqin, rezultati është pothuajse i njëjlojtë me rezultatin që u morr kur zgjatimi u bë me Drinosin në Urën e Leklit.

### 3.2. Shpërndarja brenda vjetore e rrjedhës

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë prurjet mesatare mujore për Kardhiqin në Palokastër. Me këto të dhëna dhe të reshjeve janë ndërtuar grafiket që pasqyrojnë shpërndarjen brenda vjetoreve rrjedhës.



**Prurjet mesatare mujore Kardhiq Palokastër**

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
16.6	20.3	16.3	11.7	7.33	4.24	2.43	1.95	2.18	4.02	8.10	13.1	9.01


3.3. Qëndrueshmëria e prurjeve ditore

Me poshtë jepet tabela e koordinatave te lakores se qendrueshmerise se prurjeve ditore për Kardhiqin ne Palokastër si dhe lakoret përkatëse për periudhën me të dhëna.

**Tabela Nr.4. Koordinatat e lakores se qendrueshmerise**

Prurja,m <sup>3</sup> /s	0.20	0.30	0.40	0.50	0.60	0.70	0.80	0.90	1.00	1.50
Ditet	364.80	359.67	359.07	358.9	358.9	357.21	356.41	351.48	347.48	318.57
Prurja,m <sup>3</sup> /s	2.00	3.00	4.00	5.00	6.00	7.00	8.00	9.00	10.00	
Ditet	286.06	206.18	168.01	146.0	128.6	113.52	102.8	91.67	80.81	
Prurja,m <sup>3</sup> /s	15.00	20.00	30.00	40.00	50.00	60.00	80.00	90.00	102.00	
Ditet	48.96	27.91	9.93	3.06	1.60	0.60	0.27	0.20	0.00	





Prurja maksimale

Ne studimin tone për këtë qellim është përdorur metoda racionale.

Matematikisht shprehet me ekuacionin:

$$Q_{p\%} = 0.28 * F * i * \alpha \quad \text{m}^3/\text{sek}$$

Ku

$Q_{p\%}$  = prurja e pikut me sigurinë  $p\%$  ne  $\text{m}^3/\text{sek}$ .

$F$  = sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës ne  $\text{km}^2$ .

$i$  = intensiteti i reshjeve ne  $\text{mm}/\text{ore}$ .

$\alpha$  = koeficienti i rrjedhjes qe varet nga: madhësia e reshjeve 24 orëshe me sigurinë 1%, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës dhe lloji i tokave.

#### Reshjet 24 orëshe me siguri te ndryshme

Nr	Emërtimi	Siguritë e ndryshme				
		1	2	5	10	20
1	Nivie	284	257	221	193	163
2	Kuç	234	215	188	168	146
3	Kardhiq	360	324	276	239	201
4	Ura e Leklit	254	231	201	177	153

Për llogaritjen e intensitetit orar është e nevojshme qe me pare te llogaritet koha e bashkëardhjes që në llogaritjet tona është bërë në dy mënyra:

Me formulën Vipareli

$$t_c = L / 3.6 * V \quad \text{ore}$$

Ku

$L$ =gjatësia e shtratit kryesor te përroit ne km.

$V$ =shpejtësia mesatare e maksimales të rrjedhjes (vlere që luhatet midis 1 dhe 1.5 m/s).

Me formulën Bransby-Williams

$$t_c = 22.1 * L / F^{0.1} * i^{0.2} \quad \text{ore}$$

Ku

$L$ =gjatësia e shtratit kryesor te përroit ne km.

$F$ =sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës ne km<sup>2</sup>.

$i$ =pjerrësia e shtratit te lumit ne %.

Karakteristikat morfometrike te nevojshme për llogaritjen me metodën racionale, janë nxjerre nga harta topografike të shkallës 1:25000.

Intensiteti orar përcaktohet me formulën

$$h = h_{tp} / t$$

Dhe

$$h_{tp} = H_{24,p\%} * (t/24)^n$$

Ku

$h_{tp}$ =reshjet me siguri te ndryshme p% për kohën t, ne mm.

$H_{24,p\%}$ =reshjet maksimale 24 orëshe me siguri p% ne mm.

T=koha e bashkëardhjes.

N=treguesi i reduktimit.

Reshjet maksimale 24 orëshe me siguri te ndryshme qe jane përdorur ne këto llogaritje jepen ne tabelën e mësipërme.

Rezultatet e llogaritjes se prurjes maksimale me 1% per akset e veprave se marrjes jepet ne tabelën e mëposhtme.

Prurjet maksimale në lumin e Kardhiqit hasen kryesisht ne periudhën e ftohte te vitit. Këto plota formohen zakonisht nga shira te dendur dhe te vazhdueshëm. Reshjet e shiut dhe shkrirja e dëborës jane faktorët kryesore te formimit te plotave ne lumin e Kardhiqit.

### 3. Lagështia relative e ajrit.

Si tregues i rëndësishëm i lagështirës së ajrit shërben lagështia relative e ajrit e ka një ndryshim të drejtpërdrejtë në aktivitetin njerzor. Në ecurinë vjetore të këtij treguesi vërehen ndryshime që janë të kushtëzuara nga qarkullimi stinor dhe relivi.

Nga shqyrtimi i ecurisë vjetore të lagështisë relative, sipas analizes harmonike, territori i vendit tonë ndahet në dy zona: zona bregdetare, zona malore. Ne zonen e brendëshme ku ndodhet objekti që po studiojmë maksimumi dhe minimumi i lagështisë relative zhvillohet ne oret 15 dhe 16 të ditës.

Të dhënat e tabelës më poshtë që jep lagështinë relative të vendmatjes meteorologjike te tregojne se vlerat më të larta të lagështisë relative të ajrit vërehen në periudhat e ftohta të vitit gjë që shpjegohet me veprimtarine ciklonare që vërehet në zonën e marrë në studim. Gjatë kësaj perudhe të vitit vlerat më të larta i takojnë muajve Janar, Nëntor e Dhjetor.

Nderkaq vlerat më të ulta të lagështisë relative vërehen në muajt Korrik-Gusht, pikërisht kur mbi rajonet e Mesdheut vërehet një qëndrueshmëri anticklonare e theksuar.

Ecuria ditore e lagështisë relative është e kundërt me atë të temperaturës së ajrit. Në oret e para të mëngjesit realizohen vlerat më të larta kurse në oret e mesditës (para dhe pas mesditës) vlerat më të ulëta

Tabela Nr.5. Lageshtia relative e ajrit mujore dhe vjetore, në %

Lageshtia relative e ajrit mujore dhe vjetore													
Mu	Jan	Sh	Ma	Prill	Ma	Qe	Ko	Gu	Sht	Tet	Ne	Dhj	Vjetore
	78	78	78	72	62	60	65	65	72	73	76	72	71

### 4. Avullimi dhe evapotranspirimi.

Ky element klimatik është një nga elementet klimatikë me pak të studiuar në vendin tonë. Studimet e deritanishme në vendin tonë janë përqendruar në zonat fushore ku dhe efekti i ketij elementi është më i njdjeshtëm. Aq me tepër që ne këtë zonë qe po studiohet interesi për këtë element klimatik është mjaft i ulët. Meqenëse është një element që kërkohet. Në tabelën e mëposhtme po japim vlerat mesatare mujore të evapotranspiracionit të vlerësuar për zonën në studim.



Tabela Nr.6. Evapotranspiracioni në afërsi të zonës në , mm

Evapotranspiracioni, mm													
Mua	Jana	Shk	Mar	Prill	Maj	Qers	Kor	Gus	Shta	Teto	Nent	Dhje	Vjet e
	41.1	34.2	37.3	35.6	39.1	60.0	65.0	85.0	62.0	63.2	53.2	48.2	52.0

Shenim nga autori:

*Te gjitha te dhenat e siper permendura ne lidhje me klimen, reshjet, rrjedhen ujore, etj; jane marre nga Buletinet Hidrologjike te botuara nga Instituti Hidrometereologjik te viteve perkatese.*

### VENDNDODHJA

Fshatrat Zhulat dhe Fushebardhe jane fshatra në jug të Shqipërisë në pjesën perëndimore të aksit Tepelenë-Gjirokastrë, shtrihet në gjerësi geografike 40°07'11" veri dhe gjatësi 19°59'20" lindje.



*Pamje nga larte e fshaterave Zhulat dhe Fushebardhe*



*Pamje nga larte e fshatit Zhulat*

BILANCI UJOR				
	Fushebardhe Burimi Nr.1	Fushebardhe Burimi Nr.2	Zhulat	Total
Q (l/s)	2.4	1.5	2.1	6.0


### KAPTAZHET

Ne zonen e buimit te ujit (Piriu) nga i cili furnizohet fshati Fushebardhe ne te cilin varion nje prurje minimale 5 l/s do te ndertohet nje kaptazh I cili ben te mundur qe sasia e ujit I cili sherben per nevojat e fshatit te percillet per ne depon e grumbullimit me ane te nje tubacioni PE100RC; OD 90 mm. Kaptazhi do te ndertohet ne nje kuote +912 m m.n.d. Theksojme qe nevoja mesatare e fshatit per uje eshte 2.4 l/s. Kaptazhi qe do te ndertohet eshte i tipit ku uji hyn neper vrime te cilat gjenden ne mur, paraprakisht e filtruar neper shtresa nga rera dhe zhavorri. Kjo veper do te kete mur udhezues per

ndarje dhe kahezim te rrjedhjes. Ne dhomen kontrolluese do te vendosen tubacioni I marrjes , ai I teperplotesit si dhe tubacioni fundor I shkarkimit.



Krahas burimit Piriu ne kuoten +912 m m.n.d, do te merret uje nepermjet ndertimit te kaptazhit dhe nga burimi ne kuoten +628 m m.n.d i cili ndodhet 1.5 km larg depos se fshatit, ne afersi te minieres. Nga ky burim mendohet te merret prurje mesatare me te pakten 1.5 l/s e cila do te jete nje prurje alternative per furnizimin me uje te fshatit. Burimi ne fjale ka nje prurje minimale prej 2 l/s.

*Ky burim perdoret aktualisht per furnizimin me uje te fshatit Fushebardhe.*





## UJESJELLESAT FUSHEBARDHE & ZHULAT





*Vendi ku do te ndertohet kaptazhi I fshatit Fushebardhe*

Ne zonen e burimit te ujit nga I cili furnizohet fshati Zhulat ne te cilin varion nje prurje minimale 4 l/s do te ndertohet nje kaptazh I cili ben te mundur qe sasia e ujit I cili sherben per nevojat e fshatit te percillet per ne depon e grumbullimit me ane te nje tubacioni PE100RC; OD 90 mm. Kaptazhi do te

ndertohet ne nje kuote +1035.00 m m.n.d. Theksojme qe nevoja mesatare e fshatit Zhulat per uje eshte 2.1 l/s. Kaptazhi qe do te ndertohet eshte I tipit ku uji hyn neper vrima te cilat gjenden ne mur, paraprakisht e filtruar neper shtrese nga rera dhe zhavorri. Kjo veper do te kete murin udhezues per ndarje dha kahezim te rrjedhjes. Ne dhomen kontrolluese do te vendosen tubacioni I marrjes dhe ai teperplotes si dhe tubacioni fundor I shkarkimit.

*Ky burim perdoret aktualisht per furnizimin me uje te fshatit Zhulat.*





Vendi ku do te ndertohet kaptazhi Zhula

Me poshte po paraqesim dhe te dhenat kryesore te burimeve te ujit tek te cilat do e ndertohen kaptazhet e reja te fshaterave Fushebardhe dhe Zhulat.

KAPTAZHET			
	Kaptazhi Nr.1 Fushebardhe	Kaptazhi Nr.2 Fushebardhe	Kaptazhi Zhulat
Kuotat ( m m.n.d)	912	628	1035
Q illog(l/s)	2.4	1.5	2.1
Q min.burimit (l/s)	5	2	4
Q mes.burimit (l/s)	7.3	1.5	5.5
Q max.burimit (l/s)	10.5	4	9.5

Ne rezultatin e te dhenave te mesiperme jane marre ne konsiderate edhe prurjet e vena ne dispozicion nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster sh.a. nepermje vertetimit te leshuar me date 1.09.2024 me Nr. Prot. 2623/1 bashkengjitur ketij raportit.

➤ **Llogaritja e burimeve ujore dhe formula e perdorur, perfshire % e sigurise.**

Luhatja e prurjes se burimit e vleresuar me treguesit e ndryshueshmerise shumevjecare te treguesit R, per Kaptazhin Nr.1 Fushebardhe rezulton:

$$R=Q_{max}/Q_{min}=10.5/5=2.1$$

Pra  $R=2.1$  dhe futet ne klasen e dyte ku  $R=1-2.5$ . Burimi klasifikohet si burim konstant dhe I qendrueshem.

Luhatja e prurjes se burimit e vleresuar me treguesit e ndryshueshmerise shumevjecare te treguesit R, per Kaptazhin Nr.2 Fushebardhe rezulton:

$$R=Q_{max}/Q_{min}=4/2=2$$

Pra  $R=2$  dhe futet ne klasen e dyte ku  $R=1-2.5$ . Burimi klasifikohet si burim konstant dhe I qendrueshem.

Luhatja e prurjes se burimit e vleresuar me treguesit e ndryshueshmerise shumevjecare te treguesit R, per Kaptazhin Zhulat rezulton:

$$R=Q_{max}/Q_{min}=9.5/4=2.3$$

Pra  $R=2.3$  dhe futet ne klasen e dyte ku  $R=1-2.5$ . Burimi klasifikohet si burim konstant dhe I qendrueshem.

**ANALIZAT KIMIKO-BAKTEROLOGJIKE TE UJIT TE BURIMEVE**

**Bashkengjitur ketij raporti do te gjeni te dhenat e analizave te kryera nga Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Gjirokaster.**



2597  
16-05-24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
NJËSIA VENDORE KUJDESIT SHËNDETËSOR GJIROKASTËR

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë

Nr. 0000516

datë 16/09/2024

RAPORT ANALIZE Nr. 666

Për mostrën Uj i pijshëm

Marrë në subjektin:

1. Person fizik: \_\_\_\_\_  
(emër / atësi / mbiemër i personit fizik)

2. Person juridik: Ujësullës Kanalizime Gjirokastrë  
(emërtimi i subjektit, emër - mbiemër i administratorit)

Me adresë: Zhulata Gjirokastrë (Bunimi Goulet 2)

Me aktivitet: Shërbim publik

Me proces-verbal Nr. 666, datë 12/09/2024, për sasinë e produktit: \_\_\_\_\_

me datë prodhimi: \_\_\_\_\_, datë skadence: \_\_\_\_\_

ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE / TOKSIKOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1	<u>2023</u>		
2	<u>NO<sub>2</sub> 3.40 mg/l</u>		
3			
4	<u>NO<sub>3</sub> 2 mg</u>		
5			
6			
7			
8	<u>Uj. Analiza për baktere për Qëndrueshmëri e ujit</u>		

Analizoi: Arbore Daskaj  
emër, mbiemër, nënshkrimi

ANALIZAT MIKROBIOLOGJIKE/ENTOMOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1	<u>2022C</u>		
2	<u>aktori i rrezikshëm</u>	<u>0/100 ml</u>	
3			
4	<u>Escherichia coli ne 100 ml uj</u>	<u>0</u>	
5	<u>(M.P.W)</u>		
6	<u>Uj. Analiza e rrezikshme për mostren</u>		

Analizoi: Vasil Bonhar  
emër, mbiemër, nënshkrimi

Vlerësimi higjienik dhe vendimi: Uj i pijshëm

Mjeku Higjienist: Vasil Bonhar  
Drejtori: CSIR SINO MERI

Proces-verball hartohet në 3 (tre) kopje, 1 (një) i jepet subjektit dhe 2 (dy) depozitohen në DSHP të rrethit.



2558  
16-08-2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
NJËSIA VENDORE KUJDESIT SHËNDETËSOR GJIROKASTËR

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastër

Nr. 0000515

datë 16 / 08 / 2024

RAPORT ANALIZE Nr. 665

Për mostrën Vje i pishan

Marrë në subjektin:

1. Person fizik: \_\_\_\_\_  
(emër / atësi / mblemër i personit fizik)

2. Person juridik: Vioselles Kanalizime Gjirokastër  
(emërtimi i subjektit, emër - mblemër i administratorit)

Me adresë: Zhulot - Gjirokastër (Burimi Gama 1)

Me aktivitet: Shërbim publik

Me proces-verbal Nr. 665, datë 12 / 08 / 2024, për sasinë e produktit: \_\_\_\_\_

me datë prodhimi: \_\_\_\_\_, datë skadence: \_\_\_\_\_

ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE / TOKSIKOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1			
2	<u>NO<sub>2</sub> 3.55 mg/l</u>		
3			
4	<u>NH<sub>4</sub><sup>+</sup> = 0.00</u>		
5			
6			
7			
8	<u>pa Analiza, vlerë vërtetë për</u>	<u>kuotientin e</u>	<u>kuotientit</u>

Analizoi: (Enxhela Dostaj)  
emër, mblemër, nënshkrimi

ANALIZAT MIKROBIOLOGJIKE/ENTOMOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1			
2	<u>shprehje e përqendrimit</u>	<u>0/100 ml</u>	
3			
4	<u>Escherichia coli u rritur</u>	<u>0</u>	
5	<u>(M-P-W)</u>		
6	<u>pa Analiza e shprehje për matjen</u>		

Analizoi: (Vasë Bashari)  
emër, mblemër, nënshkrimi

Vlerësimi higjienik dhe vendimi: Mjaftueshmërisht i përshtatshëm  
Mjeku Higjienist: Enxhela Dostaj

(Enxhela Dostaj)  
Drejtori: Enxhela Dostaj

Proces - verball hartohet në 3 (tre) kopje, 1 (një) i jepet subjektit dhe 2 (dy) depozitohen në DSHP të rrehtit



2601  
16-09-2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
NJËSIA VENDORE KUJDESIT SHËNDETËSOR GJIROKASTËR

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastër

Nr. 0000517

datë 16/09/2024

RAPORT ANALIZE Nr. 667

Për mostrën Mj. i pijeve

Marrë në subjektin:

1. Person fizik: \_\_\_\_\_  
(emër / atësi / mbiemër i personit fizik)

2. Person juridik: Ujësilles Komunale Gjirokastër  
(emërtimi i subjektit, emër - mbiemër i administratorit)

Me adresë: Fushëbardha - Gjirokastër (Burrmi Piri)

Me aktivitet: shërbim publik

Me proces-verbal Nr. 667, datë 12/09/2024, për sasinë e produktit: \_\_\_\_\_

me datë prodhimi: \_\_\_\_\_, datë skadence: \_\_\_\_\_

ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE / TOKSIKOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1			
2	<u>Mg<sup>2+</sup> 4.02 mg/l</u>		
3			
4	<u>Na<sup>+</sup> 2 mg</u>		
5			
6			
7			
8	<u>NO. Analiza ndërmjet vëzhgimit vizual të shfaqjes së ngjësive</u>		

Analizoi: Bojana Doraci  
emër, mbiemër, nënshkrimi

ANALIZAT MIKROBIOLOGJIKE/ENTOMOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1			
2	<u>shënim i përditshëm</u>	<u>0/100 ml</u>	
3			
4	<u>Escherichia coli në 100 ml qe</u>	<u>0</u>	
5	<u>M.P.W</u>		
6	<u>NO. Analiza e shfaqjes së moshës</u>		

Analizoi: Vasil Krasneri  
emër, mbiemër, nënshkrimi

Vlerësimi higjienik dhe vendimi:  
Mj. i pijeve shërbimet e ujësilles komunale të Gjirokastërit  
Mjeku Higjienist

(Vasil Doraci)

Drejtori  
ESLIR SHKURTARI

Proces - verball hartohet në 3 (tre) kopje, 1 (një) i jepet subjektit dhe 2 (dy) depozitohen në DSHP të rrethit.



2602  
16-09-2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
NJËSIA VENDORE KUJDESIT SHËNDETËSOR GJIROKASTËR

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë

Nr. 0000518

datë 16/09/2024

RAPORT ANALIZE Nr. 668

Për mostrën Ujë i pijshëm

Marrë në subjektin:

1. Person fizik: \_\_\_\_\_

(emër / atësi / mblemër i personit fizik)

2. Person juridik: Ujështetës Komunale Gjirokastrë

(emërtimi i subjektit, emër - mblemër i administratorit)

Me adresë: Fushëbardha - Gjirokastrë (Burrini Lemthi)

Me aktivitet: shërbim publik

Me proces-verbal Nr. 668, datë 12/09/2024, për sasinë e produktit: \_\_\_\_\_

me datë prodhimi: \_\_\_\_\_, datë skadence: \_\_\_\_\_

ANALIZAT FIZIKO-KIMIKE / TOKSIKOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1			
2	<u>NO<sub>3</sub>-N 8.81 mg/l</u>		
3			
4	<u>NO<sub>2</sub>-N 0.00</u>		
5			
6			
7			
8	<u>DO. Analiza vlerë vërtetë për qendrueshmëri e oksigjenit</u>		

Analizoi: Rejane Doka

emër, mblemër, nënshkrimi

ANALIZAT MIKROBIOLOGJIKE/ENTOMOLOGJIKE TË MOSTRËS

Nr.	ANALIZA	Rezultati	Norma
1			
2	<u>Analiza e vlerësimit të përgjithshëm të</u>	<u>0/100 ml</u>	
3			
4	<u>Escherichia coli në 100 ml</u>	<u>0</u>	
5	<u>(M-P-W)</u>		
6	<u>Analiza e staphylococcus aureus</u>		

Analizoi: Vasil Kashari

emër, mblemër, nënshkrimi

Vlerësimi higjienik dhe vendimi:

Ujë i pijshëm me cilësi të mirë

Mjeku Higjienist

Noris Doraci

Drejtori

EDUR SIMONER

Proces - verbal hartohet në 3 (tre) kopje, 1 (një) i jepet subjektit dhe 2 (dy) depozitohen në DSHP të rrethit.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

**L I C E N C Ë**  
**GJ.0244/2**

<b>MBIEMRI</b>	<b>MIRAKA</b>
<b>EMRI</b>	<b>YZEIR</b>
<b>ATËSIA</b>	<b>REFAT</b>
<b>DATËLINDJA</b>	<b>24.12.1957, Gramsh</b>
<b>VENDBANIMI</b>	<b>ELBASAN</b>
<b>DIPLOMUAR, MË</b>	<b>1982</b>
<b>TITULLI</b>	<b>Ing. Gjeolog</b>
<b>Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :</b>	<b>21.06.2017</b>



**NË PROJEKTIM**

Kat.	9	a	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
		b	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
		c	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
		d	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
		e	Studime e projekte hidrogjeologjike.

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**GERTA LUBONJA**

